



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 123/2013
Prishtinë, më 12.11.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Sala Berisha– Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi - anëtarë.

Munguan: Zenun Pajaziti, Fikrim Damka dhe Shaip Muja.

Pjesëmarrës të tjerë: Jeton Oruçi-ZKM, Rexhep Bllaca dhe Dardan Nalbani – MTI, Ukë Gashi- ZPRK dhe Burim Ejupi - INDEP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.10.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;
4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-220 për investimet e huaja;
5. Te ndryshme.

Kryesuesja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja, me kërkesë të kryetarit të Komisionit, propozoi që pika e 3-të e rendit të ditës të kalojë si pikë e 4-të e rendit të ditës.

Me këtë propozim u pajtuan dhe anëtarët e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.10.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-220 për investimet e huaja

Kryesuesja, tha se grupi i punës e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe ka nxjerr disa amendamente. Kryesuese e grupit të punës është znj. Myzejene Selmani, të cilës pastaj ia dha fjalën për t'i paraqitur amendamentet.

Myzejene Selmani, theksoi se grupi punues ka mbajtur dy takime dhe ka organizuar një workshop-punëtori, po ashtu ka mbajtur edhe dëgjim publik. Në këto takime kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, si sponsore të projektligjit dhe për të arsyetuar projektligjin në fjalë, ndërsa ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga organizata INDEP, që po e mbështesin punën e Komisionit dhe Odat ekonomike si palë e interesit, si Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane. Selmani theksoi se grupi i punës gjatë shqyrtimit, i ka hartuar 31 amendamente dhe bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Lutfi Zharku, kërkoi sqarime shtesë lidhur me amendamentin 26, i cili ndryshon nenin 14, paragrafin 3, të projektligjit, i cili rregullon çështjen e personelit të huaj që angazhohen me punë në vendin tonë dhe shfaq dyshimin lidhur me konfliktin e mundshëm me ligjin në fuqi për të huajt.

Rexhep Bllaca, tha se amendamenti 26, është në kundërshtim me ligjin në fuqi për të huajt dhe kërkoi që të mbetet sikurse është në projektligj, paragrafi 3, i nenit 14.

Sala Berisha – Shala, propozoi që ky paragraf të ndryshohet si vijon:

Neni 14, paragrafi 3, ndryshohet si vijon:

3. Personat e tillë fizik, gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, duhet që të jenë në pajtim me të gjitha ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Propozimi i deputetes Sala Shala – Berisha u miratua nga Komisioni.

Lutfi Zharku, propozoi që amendamenti 31 apo amendamenti i fundit, për të mos lënë paqartësi, që të ndryshohet si në vijim:

Neni 22, pas paragrafit 4, i shtohet edhe një paragraf i ri si vijon:

5. Me hyrjen ne fuqi të këtij ligji, bëhet bashkimi i “Agjencisë së Promovimit dhe Investimeve në Kosovë dhe Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”, ku të drejtat dhe detyrimet i barten Agjencisë.

Propozimi i deputetit Lutfi Zharku u miratua nga Komisioni.

Visar Ymeri, theksoi se vota e tij do të jetë kundër miratimit të këtij projektligji.

Pas debatit Komisioni me 7 vota Për, 1 Kundër, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit Nr. 04/L-220 për investimet e huaja.

2. Raporti t’u procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave

Kryesuesja, tha se pas shqyrtimit edhe nga ana e komisioneve të përhershme të Raporti me amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-202, për sistemin e lejeve dhe licencave, vetëm Komisioni për legjislacion ka dhënë vërejtje, dhe sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të procedohet për seancë plenare. Po ashtu, kryesuese e grupit të punës është znj. Myzejene Selmani, të cilës pastaj ia dha fjalën për t’i prezantuar amendamentet.

Myzejene Selmani, tha se pas kërkesës së Komisionit tonë të datës 22.10.2013, për Komisionin për Legjislacion që të kemi një takim në lidhje me vërejtjet që kanë paraqitur në këtë projektligj, në bazë të raportit të datës 7.10.2013. Komisioni për Legjislacion ka kthyer përgjigjen më 24.10.2013, si në vijim: “Komisioni nuk do të marr pjesë në takimin e përbashkët apo grupin punues, pasi vlerëson se kjo është e pa nevojshme sepse rekomandimi i Komisionit për Legjislacion i datës 7.10.2013, është shumë i qartë dhe mbetet obligim i Komisionit FunkSIONAL ta procedojë tutje.” Më pas kryetari i Komisionit, ka kërkuar nga Qeveria që të përmirësojë dy nenet kontestuese dhe tani në Raport e keni amendamentin 10 dhe 19, të cilët janë riformuluar dhe nuk përbëjnë shkelje kushtetuese. Selmani kërkoj nga Komisioni që të përkrahet ky raport dhe të procedohet për seance plenare.

Amendamentet apo nenet e përmirësuara janë si në vijim:

Amendamenti 10

Neni 3, nënparagrafi 1.10, riformulohet si vijon:

1.10. **Person** – person fizik apo person juridik.

Amendamenti 19

Neni 15, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

3. Nëse një autoritet kompetent, që është agjenci e pavarur dhe i raporton Kuvendit, propozon një projekt-akt, që ka ndikim në veprimtarinë ekonomike ose përfshin vendosjen ose rishikimin e një kërkesë për lejim, ky autoritet kompetent, do të dorëzojë projekt aktin te komisioni parlamentar i fushës përkatëse, së bashku me një mendim të hollësishëm me shkrim për konformitetin e projekt-aktit të propozuar me këtë ligj.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetes Selmani, që Projektligji të procedohet tutje për shqyrtim në seance plenare.

Lutfi Zharku, tha se qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së, nuk ka ndryshuar që ky projektligj është i panevojshëm dhe duhet ti kthehet Qeverisë për ridraftim.

Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit Nr .04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.

2. Raporti t'i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Myzejene Selmani, paraqiti vërejtje në lidhje me përbërjen e delegacionit të Komisionit, që do të merr pjesë në Bruksel, më datën 25 dhe 26 nëntor të këtij viti. Ajo shtoi se edhe në Kryesi të Kuvendit është diskutuar kjo çështje dhe kërkoi nga kryetari i Komisionit, që herëve të tjera mos të formojë delegacion për udhëtime jashtë vendit, pa e marr miratimin e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetarja e Komisionit,

Teuta Sahatqija